



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. Rregj. Them. 7261/2697/603

Data e rregjistrimit 17.09.2014

Nr. Vendimit 400

Data e vendimit 03.03.2016

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

<b>Lindita SINANAJ</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Artur MALAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Alkelina GAZIDEDJA</b>	<b>Anëtare</b>

me sekretare gjyqësore *Visela Kashari*, në Tiranë, sot në datë 03.03.2016, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative, që i përket palëve:

**PADITËS:** *Çapajev Aliaj*, i biri i Tetemit dhe i Thëllëzës, i datëlindjes 05.01.1990, lindur e banues në Mallakastër.

**E PADITUR:** *Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.*

**OBJEKTI:**

- Dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës, neni 155.
- Dëmshpërblim për mosrespektim të afateve të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, neni 143/2.

-Dëmshpërblim për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, neni 144.

-Pagesa e pushimeve vjetore të vitit 2013 në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës.

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative”. Ligji “Për nëpunësin civil”. Nenet 143/2, 144, 149, 155 e 92/3 të Kodit të Punës.

### **GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT**

pasi dëgjoji relacionin e kryesueses së trupit gjykues, shqyrtoi pretendimet e parashtruara në ankim nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimor Fier, që kërkon:

*-ndryshimin e vendimit nr. 462 datë 07.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe rrëzimin e kërkesë padisë.*

dhe bisedoi çështjen në tërësi:

### **VËREN**

Në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 17.09.2014 është rregjistruar ankimin i paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, kundër vendimit Nr. 462 datë 07.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, bazuar në nenet 442, 443 të K.Pr.Civile dhe nenin 48 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative”. Ky ankim është paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë në datën 05.06.2014. Kjo Gjykatë me vendimin e saj datë 09.06.2014 ka vendosur pranimin e ankimit të palës së paditur, duke dërguar në Gjykatën

Administrative të Apelit, ankimin së bashku me aktet e njoftimit të tij, si dhe dosjen e gjykimit për shqyrtim.

Nga aktet e dosjes së gjykimit rezulton se në datën 17.02.2014, pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, me padinë objekt gjykimi. Kjo Gjykatë, me vendimin nr. 462, datë 07.04.2014, ka vendosur: *“Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë së paditësit si të bazuar në prova dhe në ligj. Mospranimin e kërimit lidhur me detyrimin e të paditurit t’i paguajë paditësit dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës në bazë të nenit 155/3 të Kodit të Punës dhe për pushimet vjetore. Detyrimin e të paditurit t’i paguajë paditësit 1 muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit, në bazë të nenit 143 e 146/3 të Kodit të Punës. Detyrimin e të paditurit t’i paguajë paditësit 2 muaj pagë për shkeljen e procedurës të parashikuar në nenin 144 të Kodit të Punës, në bazë të nenit 144/5 të Kodit të Punës. Detyrimin e të paditurit t’i paguajë paditësit gjithsej 3 muaj pagë. Paga bruto e paditësit është 72.080 lekë. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të paditurit. Urdhërohet zyra e përmbarimit me ekzekutimin e këtij vendimi nga dita që vendimi të marrë formë të prerë dhe në një kësht të vetëm. Ndaj këtij vendimi nuk nxirret urdhër ekzekutimi. Kundër vendimit lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit, kurse për palën në mungesë ky afat fillon nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit”.*

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier duke parashtruar këto pretendime:

- ✓ Vendimi i gjykatës është i pambështetur në ligj dhe duhet të ndryshohet duke u vendosur rrezimi tërësisht i padisë.
- ✓ Paditësi ka qënë në detyrë nëpunës me emerim të përkohshëm, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në këto kushte dispozitat ligjore në fuqi nuk parashikojnë asnjë formë apo procedurë të zgjidhjes së marrëdhënies së punës të përkohshme.
- ✓ Marrëdhënia e punës ka qënë e kushtëzuar me përfundimin e procedurave të konkurimit për këtë pozicion pune dhe pikërisht në përfundim të procedurave të konkurimit për pozicionin e punës është emëruar një nëpunës civil sipas rezultateve të testimit dhe është liruar nga detyra paditësi.

- ✓ Procedura e ndjekur nga administrata tatimore për këtë pozicion dhe për të gjitha pozicionet e lira është tërësisht e ligjshme.
- ✓ Dispozitat ligjore për nëpunësit civil nuk parashikojnë dëmshpërblim për rastet e zgjidhjes së marrëdhënies së punës aq më tepër në plotësim të kushtit që legjitimonte këtë marrëdhënie punësimi.
- ✓ Padiësi nuk mund të kërkojë dëmshpërblim referuar Kodit të Punës pasi marrëdhënia e tij nuk rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës, nga ana tjetër dispozitat kushtetuese dhe aktet e tjera ligjore që rregullojnë funksionimin e administratës publike dhe nëpunësve civil në RSH saktësojnë shprehimisht se nëpunësit civil përzgjidhen vetëm pas procedurave të konkurimit, për këtë arsye emërimet në detyrë të padiësit në administratën tatimore janë emërimet të përkohshme të cilat në kuptim të ligjit organi administrativ mund t'i ndërpresë në momentin e plotësimit të kushtit ligjor mbi të cilin janë lidhur.

*Për sa më sipër pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 462 datë 07.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe rrëzimin e kërkesë padisë.*

#### ***Rrethanat faktike të çështjes***

Padiësi Çapajev Aliaj është diplomuar në Universitetin “Kristal” Tiranë, Dega Financë, fakt që provohet me diplomën nr. 696 datë 01.09.2011. Gjithashtu, padiësi është diplomuar në Master i Shkencave në Financë me diplomën me nr. 272 datë 03.09.2013. Ai ka filluar punë në datën 12.01.2012 në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier në detyrën “Inspektor i dytë në Sektorin e Përpunimit, Vlerësimit dhe Kontabilitetit të të Ardhurave”, më pas në datën 02.04.2012 është transferuar nga kjo detyrë me vendimin nr. 6848 prot., datë 02.04.2012 dhe është emëruar Inspektor i dytë në Sektorin e Verifikimit në Terren në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, fakt që provohet nga vendimi nr. 6848 prot., datë 02.04.2012 i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve. Në datën 16.01.2014, me shkresën nr. 991 prot., ka dalë vendimi nr. 83 i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve me të cilin padiësi është njoftuar për lirimin e tij nga detyra. Në këto

kushte paditësi i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesë padinë objekt gjykimi, duke kërkuar zgjidhjen e mosmarrveshjes së punës me palën e paditur në rrugë gjyqësore.

Në analizë të pretendimeve të parashtuara, të provave e akteve shkresore të administruara dhe rrethanave të faktit e të ligjit, gjykata ka konkluduar se marrëdhënia e punës mes palëve ndërgjyqëse është zgjidhur nga ana e palës së paditur në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara. Gjykata ka argumentuar se për shkak të zgjatjes së marrëdhënieve të punës për një periudhë relativisht të shkurtër duhet rrëzuar kërkitimi i paditësit për dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës. Gjykata cmon se paditësi nuk përfiton nga ligji për nëpunësin civil, por nga Kodi i Punës.

Kërkimi i paditësit lidhur me dëmshpërblimin për mosrespektim të afatit të njoftimit është vlerësuar i bazuar për shkak se nga ana e palës së paditur nuk është respektuar ky afat, i cili në bazë të nenit 143 pika 1 të Kodit të Punës, duhet të ishte 1 muaj. Për rrjedhojë, pala e paditur ka detyrimin për t'i paguar paditësit 1 muaj pagë, si dëmshpërblim për mosrespektimin e afatit të njoftimit. Po kështu, pala e paditur, e cila kishte dhe barrën e proves, bazuar në nenin 144 pika 1/5 të Kodit të Punës, nuk arriti të provonte në gjykim respektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. Për këtë arsye, pala e paditur detyrohet t'i paguajë paditësit një dëmshpërblim në shumën e 2 pagave mujore.

#### ***Vlerësimi i çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit***

***Së pari*** gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimit objekt i këtij gjykimi. Në referim të nenit 7 gërma "ç", nenit 10 paragrafi 2 gërma "a" dhe nenit 44 të Ligjit Nr. 49/2012, kjo Gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

***Së dyti*** vlerëson të marrë në shqyrtim kushtet e pranueshmërisë së ankimit. Sikurse është referuar edhe më sipër në këtë vendim, rezulton që vendimi të jetë shpallur në datën 07.04.2014, ndërsa ankimi nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier është paraqitur në datën 05.06.2014, pra brenda afatit pesëmbëdhjetëditor, të përcaktuar në nenet 443 paragrafi i parë dhe 444

paragrafi i parë të Kodit të Procedurës Civile. Po kështu, nuk rezultojnë kriteret penguese të parashikuara në nenin 45 të ligjit nr. 49/2012 që e bëjnë vendimin të paankimueshëm. Ankimi rezulton të jetë i plotë edhe në elementët e tjerë, si në elementët e formës edhe të përmbajtjes, lidhur me nënshkrimin nga pala që e ka paraqitur, tregimin e palëve ndërgjyqëse, vendimin kundër të cilit është paraqitur, apo kërkimet për të cilat ai është paraqitur. Për të gjitha sa më sipër gjykata cmon se ankimi i paraqitur kundër vendimit nr. 462, datë 07.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, objekt gjykimi, duhet të pranohet për shqyrtim.

**Së treti** Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor të zhvilluar në shkelje të rënda të rregullave procedurale mbi zhvillimin e procesit gjyqësor dhe marrjen e vendimit, shkelje këto që passjellin pavlefshmërinë e vendimit dhe të procedurës së gjykimit. Për këtë shkak vendimi duhet të priset dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim.

Nga shqyrtimi i procesverbalit të seances gjyqësore, të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, rezulton se nga ana e kësaj gjykate nuk janë marrë efektimisht në shqyrtim provat, në të cilat kanë mbështetur pretendimet e tyre palët ndërgjyqëse. Pra konstatohet mungesa e marrjes së provave dhe shqyrtimi i këtyre provave, veprim ky i domosdoshëm i parashikuar në nenin 180 paragrafi i tretë i K.Pr.Civile në të cilin është parashikuar shprehimisht se *“...Secili prej tyre (paditesi, i padituri dhe pjesmarresit e tjere ne proces) është i detyruar të përcaktojë faktet dhe provat mbi të cilat mbështeten pretendimet e prapësimet e tyre.”*

Në këtë konkluzion kjo Gjykatë arrin në analizë të parashikimeve të nenit 213 të K.Pr.Civile sipas të cilit *“Në zbatim të nenit 12 të këtij Kodi, gjykata me vendim lejon palët të provojnë faktet mbi të cilat i bazojnë kërkimet dhe pretendimet e tyre, duke paraqitur në gjykatë vetëm ato prova që janë të domosdoshme e që kanë lidhje me çështjen e gjykimit.”* Pra mungesa e pasqyrimin në procesverbal të kërkimit për marrjen e provave konkrete dhe mosmarrja e vendimit nga ana e gjykatës për lejimin ose jo të provave, çon në konkluzionin e moszhvillimit të kësaj veprimtarie procedurale gjatë gjykimit në shkallë të parë. Kjo shkelje procedurale çon në cënimin e

parimeve kryesore të gjykimit të mosmarrveshjeve të parashikuara në nenet 11, 12, 14, 19, 20 e 29 të K.Pr.Civile.

Neni 12 i K.Pr.Civile përcakton se: *“Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj.”*

Neni 11 i K.Pr.Civile parashikon shprehimisht se: *“Provat janë të dhëna që merren në formën e parashikuar nga ky Kod dhe që vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet ose prapësimet e pjesëmarrësve në proces”.*

Neni 14 i K.Pr.Civile parashikon se *“Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin.”*

Neni 19 i K.Pr.Civile parashikon se: *“Palët duhet t'i bëjnë të njohur njëra-tjetrës, në kohën e duhur, mjetet dhe faktet mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre, provat që do të paraqesin dhe dispozitat ligjore që do t'u referohen, në mënyrë që të bëhet e mundur për secilën palë mbrojtja e interesave të tyre në gjykim.”*

Neni 20 i K.Pr.Civile parashikon se *“Gjykata duhet të ndjekë dhe të kërkojë të zbatohet parimi i kontradiktoritetit. Ajo mbështet vendimin e saj vetëm në mjetet, shpjegimet, dokumentet e provat e tjera të treguara ose të sjella nga palët, kur këto të fundit kanë qenë në gjendje të debatojnë sipas parimit të kontradiktoritetit.”*

Në nenin 29 të po këtij kodi parashikohet se *“Gjykata mbështet vendimin në provat e paraqitura nga palët ose nga prokurori, të marra në seancë gjyqësore. Gjykata çmon provat që ndodhen në aktet, në bazë të bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi në tërësinë e tyre i rrethanave të çështjes.”*

Në vijimësi të këtij parimi edhe në nenin 309 të K.Pr.Civile është parashikuar se *“Vendimi mbështetet vetëm në të dhëna që ndodhen në aktet dhe që janë shqyrtuar në seancë gjyqësore.”*

*Gjykata çmon provat e marra gjatë gjykimit të çështjes, sipas bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre.”*

Në interpretim të këtyre dispozitave rezulton që vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë mbi bazën e akteve dhe provave që nuk rezulton të jenë shqyrtuar në seancë gjyqësore, kërkesë kjo e domosdoshme e nenit 309 të sipërcituar. Mjetet, shpjegimet, dokumentet e provat e analizuara në vendim nuk rezulton të jenë treguar apo kërkuar nga palët në proces. Shkelja e këtyre parimeve themelore në marrjen e vendimit passjell pavlefshmërinë e tij. Sipas gërmës “ç” të nenit 50 të ligjit nr. 49/2012, Gjykata Administrative e Apelit në dhomë këshillimi vendos prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në rastin kur shkeljet proceduriale janë të rënda dhe për të cilat ligji parashikon shprehimisht pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjykimit. Në rastin në gjykim Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka shkelur rëndë rregullat mbi marrjen e vendimit dhe procedurën e zhvillimit të gjykimit, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara të Kodit të Procedurës Civile.

Duke u bazur në sa me sipër, Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50 germa “ç” të ligjit nr. 49/2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative*”, përfundimisht vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë duhet prishur dhe çështja duhet dërguar për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

#### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të neneve 49 e 50 gërma “ç” të ligjit Nr. 49/2012  
*”Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative”*,

#### **VENDOSI**

Prishjen e vendimit nr. 462, datë 07.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Kundër vendimit lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

Tiranë më 03.03.2016.

**ANËTARE**  
**Alkelina GAZIDEDJA**  
*(kunder)*

dv

**ANËTAR**  
**Artur MALAJ**

dv

**KRYESUESE**  
**Lindita SINANAJ**

dv

**Vertetohet njesia me origjinalin**

*Kancelosi  
Leonard Shatrij  
Shatrij*